



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr.52, datë 11.11.2015

Për

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 33, DATË 18.11.2013, PËR “MENAXHIMIN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA NË KUADËR TË PROJEKTIT “NDËRTIMI I BANESAVE ME QËLLIM SOCIAL”, NË ZONËN E SHKOZËS, ISH FONDERIA MEKANIKE””.

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 33, pika 2 të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”(i ndryshuar); nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (i ndryshuar); ligjit nr.9232, datë 13.05.2004, për “Programet sociale të strehimit” (i ndryshuar); pikës 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.260, datë 24.02.2010, për “Metodikën e llogaritjes së masës së qirasë, kur banesat sociale me qira financohen nga buxheti i shtetit ose buxheti i bashkive apo nga kombinimi i të dyjave” me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Pas pikës 2 të vendimit nr.33, datë 18.11.2013, për “Menaxhimin e banesave sociale me qira në kuadër të projektit “Ndërtimi i banesave me qëllim social”, në zonën e Shkozës, ish Fonderia Mekanike” shtohet pika 2/1 me përmbajtje si më poshtë:
“Të çelet një llogari e veçantë në degën e Thesarit në emër të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.3 të Puntorëve të Qytetit, me qëllim derdhjen e të ardhurave që vijnë nga pagesat e qirasë”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Aldrin DALIPI